



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS KUVENDI I KOMUNËS

Projekt:

PLANI I VEPRIMIT PER TRANSPARENCE NË KOMUNËN E KLINËS

Klinë, Shkurt 2018

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008) dhe në zbatim të Udhëzimit administrativ, Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna si dhe Rregullores për Transparencë ne Komunën e Klinës /2014, Kuvendi i Komunës se Klinës, në seancën e ___ të rregullt, të mbajtur më datën ___/___/2018, miratoi:

D r a f t:

**PLANIN
E
VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË
KOMUNËN E KLINËS**

Hapat konkretë që Komuna e Klinës, do të ndërmarrë në funksion të përmbushjes së planit të veprimit dhe rekomandimeve të ekzekutivit të komunës, përfshin objektivat si në vijim:

1. Objektivi i parë, i përcaktuar në këtë plan ka të bëjë me rritjen e transparencës të institucioneve komunale ndaj publikut të gjerë. Në këtë kuadër parashikohet:

1.1.Rritja e stafit në Zyrën e Informimit të paktën 2 zyrtar.

1.2. Organizimi i seancave dëgjimore për projekt-rregulloret e aktet tjera të hartuara nga Ekzekutivi i Komunës;

1.3. Publikimi i dokumenteve të Kuvendit dhe Ekzekutivit në ueb faqen zyrtare të Komunës, menjëherë pas miratimit të tyre në të dy gjuhët zyrtare.

2. Objektivi i dytë, konsiston në rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile, ku synohet një proces konsultimi më transparent dhe gjithëpërfshirës të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë në funksion të rritjes së besimit të publikut për hartimin e akteve në nivel lokal. Për të përmbushur këtë objektiv, Plani i Veprimit parashikon ndër të tjera:

2.1.Ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si fëmijët, gratë, personat me nevoja te veçanta etj, të cilët në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë do të kenë në qendër të vëmendjes problematikat e këtyre grupeve;

2.2. Organizimin e takimeve me shoqërinë civile, për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit;

2.3. Përmirësime sipas nevojës në Rregulloren përTransparencën ne Komunën e Klinës, për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë sipas nevojave e qe ndërliidhen me bashkëpunimin dhe qasjen e organizatave të shoqërisë civile në punimet e Kuvendit të Komunës;

2.4. Çështja e azhurnimit lidhur me Publikimin e projekt -akteve nënligjore komunale në ueb faqen zyrtare të Komunës, si dhe relacionet e tjera lidhur me këtë.

Masat konkrete që duhet të merren dhe të zbatohen konsistojnë në:

1. Publikimi i rregullt në mënyrë elektronike të projekt-akteve dhe postimit të tyre në ueb faqen komunale, në të dy gjuhët zyrtare;
2. Freskimi i vazhdueshëm i ueb-faqes të Komunës së Klinës.
3. Komunikimet me ekzekutivin e Komunës.

3. Objektivi i tretë, ka të bëjë me forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit.

Në këtë kuadër parashikohet:

3.1 Mbatja e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit, mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe konsultimeve me publikun me mundësin e pjesëmarrjes sa ma te madhe të publikut.

3.2 Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetin vjetor komunal.

3.3 Përfshirja e raporteve të ndryshme të institucioneve dhe organizatave që lidhen me planin e veprimit të punës së kuvendit.

4. Objektivi i katërt, parasheh përmirësimin e performancës së institucioneve të komunës, si

4.1 Marrja në konsideratë të rekomandimeve, sugjerimeve të institucioneve dhe organizatave tjera dhe ngritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve komunale, duke e përshtatur agjendën me prioritetet që rrjedhin nga MSA-ja për komuna.

5. Objektivi i pestë, parasheh forcimin e kapaciteteve administrative përkatëse të resorëve përkatës apo komunës si tërësi;

5.1 Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës;

5.2 Rritjen e kapaciteteve për shërbimin e teknologjisë së informacionit në Zyrën e Informimit;

5.3 Sigurimin e buxhetit nga donacionet për kompensimin e një numri të caktuar të stafit këshillëdhënës për Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e KK-së etj.

6. Objektivi i gjashtë, parasheh që Plani i Transparencës do të ndryshohet dhe plotësohet sa herë që është e nevojshme në pajtim legjislativ që rregullon çështjen e transparencës.

NR. _____/2018

Klinë, dt. __/__/2018

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

**K r y e s u e s i,
Fadil Gashi**